

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-36/13

**Prishtinë,
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të

S.S

Pala ankuese

kundër

Z.V

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/158/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numrat KPA00706 dhe KPA91507) të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 12 nëntor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet ankesa e S.S kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/58/2012, i datës 6 qershor 2012, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrat KPA00706 dhe KPA91507.**

- 2- **Konfirmohet vendimi i të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/58/2012, i datës 6 qershor 2012, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrat KPA00706 dhe KPA91507.**

Çështjet procedurale

Më 25 tetor 2007, Z.V ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar pronësinë e 2/4 të ngastrës nr. 332 dhe 333 në Dervar, Vushtrri. Si bazë për kërkesën e saj ajo ka paraqitur një kontratë mbi dhurimin të datës 11 nëntor 1997 nga D.S. Nënshkrimet e palëve ishin konfirmuar nga Gjykata Komunale në Vushtrri më 13 shkurt 1998. Kontrata dhe konfirmimi nga gjykata i nënshkrimeve janë verifikuar nga AKP-ja.

Para kësaj Komisioni për Çështje Pronësore-Banësore (KÇPB) me datë 27 gusht 2004 ka urdhëruar posedimin e pronës në Drvare nr. 13, Komuna e Vushtrrisë Ngastra Kadastrale nr. 332 nga D.S. Në vendim ceket se prona ishte shkatërruar pasi që D.S e kishte humbur posedimin e pronës dhe se prona ishte e zbrazët.

D.S kishte vdekur me 7 janar 2004.

Me vendimin e datës 27 shtator 2010, AKP-ja i ka ndarë kërkesat në atë mënyrë që kërkesa fillestare KPA00706 tani ka të bëjë vetëm me ngastrën 333 ndërsa kërkesës që ka të bëjë me ngastrën 332 i ishte dhënë numri KPA91507.

S.S është përgjigjur në kërkesë, duke theksuar se e kishte të drejtën ligjore ndaj të dy pronave. Ai ka deklaruar kjo tokë historikisht i përkiste stërgjyshërve të tij dhe se ishte uzurpuar në vitin 1912. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion të pronësisë.

Në vendimin e tij KPCC/D/A/155/2012 të datës 6 qershor 2012, KKPK-ja kishte vendosur që Z.V ishte pronare e 2/4 të të dy pronave, dhe se ajo e kishte të drejtën e posedimit të tyre. KKPK-ja ka gjetur se Z.V kishte paraqitur dëshmi se ajo kishte paraqitur prova të pronësisë për të dy pronat dhe se Komisioni nuk kishte juridiksion për të vendosur për çështjet e eksproprijimit që kanë ndodhur para kësaj dhe që nuk ishin të ndërlidhura me konfliktin e viteve 1998/1999.

Vendimi i ishte dorëzuar Salih Salihut më 11 dhjetor 2012. Ai ka paraqitur ankesë kundër të dy vendimeve më 8 janar 2013. Në ankesën, e cila i referohet të dy lëndëve, S.S ka dhënë një përshkrim të gjerë të çështjeve historike në Kosovë. Argumenti i tij kryesor është se familja e tij e kishte humbur pronë e tij pas vitit 1912 për shkak të kolonializmit serb dhe se prona më të drejtë i takon atij. Pas konfliktit të viteve 1998/1999 ai, sikurse edhe bashkatdhetarët e tij, kishte të drejtë që të kërkonte pronën. S.S deklaron se Parlamenti Evropian dhe Qeveria e Kosovës kanë rol në zgjidhjen e drejtë të çështjes pronësore në Kosovë. S.S kërkon që Gjykata Supreme ta anulojë vendimin e KKPK-së me qëllim të korrigjimit të padrejtësisë pronësore në Kosovë.

Ankesa i është dorëzuar Z.V më 16 korrik 2013. Ajo është përgjigjur në ankesë në të ty lëndët më 22 korrik 2013. Ajo kundërshton argumentet e ngritura nga S.S si të natyrës historike dhe jo relevantë për rastin.

Bashkimi i lëndëve

Salih Salihu ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së në lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA00706 dhe KPA91507. Lëndët janë paraqitur në Gjykatën Supreme si lëndë me numrat GJK-KPA-A-036/13 dhe GJK-KPA-A-037/13. Lëndët janë ndërmjet palëve të njëjta. Vetëm numrat kadastral janë të ndryshëm. Bashkimi i lëndëve do të kontribuonte në efikasitetin e procedurës.

Në përputhje me këtë, Gjykata Supreme nxjerrë një urdhër për bashkimin e lëndëve nën numrin GJK-KPA-A-036/13 në përputhje me nenin 408.1 dhe nenin 193 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilët zbatohen *mutatis mutandis* sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Arsyetim ligjor

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Kërkesa e paraqitur nga Z.V në AKP ka të bëjë me humbjen e pronës më 12 qershor 1999 për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 dhe se ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë të drejtat e saj për shkak të këtyre rrethanave. Në këtë mënyrë kjo është në mandat të KKPK-së siç përcaktohet me Rregullorën e UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin nr. 03-L-079. Kërkesa është e pranueshme.

Z.V ka paraqitur prova në AKP se sipas kontratës mbi dhurimin të datës 12 shkurt 2012, ajo është pronare e 2/4 të ngastrës nr. 332 dhe 333 në Vushtrri. Kjo dhuratë i është dhënë D.S, të cilin AKP-ja e ka verifikuar se është i njëjti person me D.S.

S.S e ka konfirmuar në ankesë se ai e kishte marrë posedimin e pronës pas konfliktit të armatosur, duke cekur se toka i përkiste familjes së tij para vitit 1912. Ai nuk ka sugjeruar apo dokumentuar ndonjë të drejtë ndaj pronës përveç kërkesës së tij historike.

Kërkesa dhe ankesa janë në juridiksion të Gjykatës Supreme. Megjithatë, gjykata mund të vendos vetëm për lëndët në kuadër të kornizës së përcaktuar me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, çështje këto që ndërlidhen me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999. Argumentet që S.S i ka paraqitur më ngulm lidhur me çështjet historike të pronësisë së pronës janë jashtë juridiksionit të Gjykatës Supreme.

Prandaj, Gjykata Supreme pajtohet me KKPK-në se Z.V e ka dëshmuar kërkesën e saj.

Më 27 gusht 2004, KÇPB-ja ia ka dhënë D.S posedimin e ngastrës kadastrale nr. 332 si bartës i së drejtës pronësore. Urdhri ishte nxjerrë pas një procedure jo kontestimore. Ky vendim nuk e bën lëndën e tanishme Res Judicata sepse ai shprehimisht thekson se::

“Urdhri mund të zgjidh vetëm të drejtën në pranimin e zgjidhjes deklarative. Ai nuk vendos përfundimisht ndonjë të drejtë tjetër ligjore, çështje apo kontest lidhur me pronën e kërkuar. Në rastet kur ka më tepër së një pronar, urdhëresa nuk ndikon në të drejtat e bashkëpronarëve”

Në të njëjtën mënyrë, ky aktgjykim është detyruar vetëm ndërmjet Z.V dhe S.S, dhe nuk ndikon në të drejtat e bashkëpronarëve.

Shpenzimet e procedurës:

Në vendimet e mëparshme të saja Gjykata Supreme ka marrë qëndrimin që kur palët janë përjashtuar nga shpenzimet procedurale para KPKK-ës, ky përjashtim nuk është paraparë për procedurën para Kolegjit të Apelit. Në pajtueshmëri me këtë pala e cila ka humbur rastin/lëndën ishte obliguar që të paguante shpenzimet gjyqësore në përputhshmëri me Ligjin mbi Shpenzimet (Gazeta Zyrtare e KSAPK-3 tetor 1987) dhe UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore.

Neni 12.2 i Regullorës së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 (UNMIK) 06 thekson se, përderisa nuk është paraparë ndryshe, Ligji i Procedurës Kontestimore, i cili posedon dispozita ligjore për sa i

përket shpenzimeve gjyqësore, duhet të aplikohet *mutatis mutandis* në procedurën e ankesës para Gjykatës Supreme.

Në nenin 13.5 të UNMIK 06 është thënë se:

“Në interpretimin e Rregullorës ekzistuese ose ndonjërin nga Udhëzimet Administrative mbi aplikimin e Rregullorës ekzistuese, Gjykata Supreme e Kosovës mund t’i zbatojë, me ndryshimet ose cilësimet të cilat janë të nevojshme ose e përshtatshme në rrethanat e caktuara, dispozitat e ligjeve të aplikuar mbi kompetencat e Gjykatës Supreme në procedurën civile.”

Kjo vijon nga kjo dispozitë që Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme i është dhënë kufizim në vlerësim kur aplikohen ligje të përgjithshme sa i përket procedurës civile në ankesat kundër vendimeve të marra nga KPKK-ja. Gjykata Supreme e nënkupton këtë si një përgjigje në çështjet e veçanta dhe të ngritura në këto lëndë. Në interpretimin e këtyre ligjeve Gjykata Supreme merr në konsideratë qëllimet e ligjit dhe gjendjen evolutive të ligjit në kohën e zbatimit të ligjeve.

Gjykata Supreme e nënkupton këtë si një rregull kryesore meqë palët para KPKK-ës dhe Kolegjit të Apelit të AKP-ës janë shumë të atakuara.

Për paraqitësit e kërkesave dhe palët përgjegjëse njësoj, shpenzimet e përcaktuara gjyqësore nga Gjykata Supreme, mund të ishte një barrë serioze e cila mund të ketë efekt në qasjen e tyre në drejtësi. Për më tepër palët që para Gjykatës Supreme janë palë përgjegjëse në ankesë mund të detyrohen për pagimin e shpenzimeve gjyqësore edhe pse nuk kanë ankimuar vendimet e KPKK-ës. Praktika ka treguar se nuk është e jashtëzakonshme që ankuesit nuk kanë qenë në dijeni për procedurën para KPKK-ës, për shkak të fajit të tyre, dhe se ankesa pranë Gjykatës Supreme është e vetmja mundësi për të atakuar kërkesat e pakontestuar të KPKK-ës. Për më tepër, palët të cilat janë palë përgjegjëse para Gjykatës Supreme, mund të ngarkohen me shpenzime edhe pse ato vetë nuk e kanë ankimuar vendimin e KPKK-ës.

AKP-ja, KPKK-ja dhe Kolegji i Apelit të AKP-ës janë krijuar me qëllim që të krijohet çasje e thjeshtë dhe e vërtetë në drejtësi për sa i përket kërkesave të palëve që nuk kanë pasur mundësi t’i ushtrojnë të drejtat e veta pronësore. Mbi bazën e eksperiencës së fituar përgjatë këtyre viteve të fundit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se shpenzimet gjyqësore mund të paraqesin pengesë për pasjen qasje në drejtësi, njësoj si për paraqitësit e kërkesave ashtu edhe për palët përgjegjëse në kërkesë. Kjo nuk ishte vullneti i ligjbërësit.

Në pajtueshmëri me këtë, Gjykata Supreme e Kosovës që nga sot rishikon jurisprudencën (praktikën) e saj, dhe vendos që të interpretoj Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore në mënyrë të kufizuar, prandaj kjo nuk është e aplikueshme në ankesat para Gjykatës Supreme për sa i përket vendimeve të marra nga KPKK-ja.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it